

---

**UDHËZIM Nr. 3, datë 21.2.2019**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 3.11.2014,  
PËR ZBATIMIN E REGJIMIT TË VEÇANTË TË SKEMËS SË KOMPENSIMIT TË  
PRODHUESVE BUJQËSORË PËR QËLLIME TË TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 8 “Mënyra e zbatimit të skemës së kompensimit”, pika 2, togfjalëshat: “...përfshirë normën e kompensimit e cila është 20%” dhe “TVSH-ja e shënuar në faturë prej 20%...”, bëhen

“përfshirë normën e kompensimit e cila është 6%”, dhe “TVSH-ja e shënuar në faturë prej 6%...”.

2. Në nenin 9 “E drejta e zbritjes së TVSH-së së kompensuar”, pika 3, togfjalëshi: “Personi i tatueshëm blerës nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin prej 20% ...”, bëhet “Personi i tatueshëm blerës nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin prej 6% ...”.

3. Në nenin 11 “Deklarimi” bëhen këto ndryshime:

3.1 Në pikën 1, togfjalëshi “... produkt i vlerës së tatueshme të mallit me përqindjen e kompensimit, e cila sipas këtij ligji është 20%.”, bëhet “... produkt i vlerës së tatueshme të mallit me përqindjen e kompensimit, e cila sipas këtij ligji është 6%.”.

3.2 Në pikën 2, togfjalëshi “Për qëllime të llogaritjes së normës së kompensimit në masën 20%, ...”, bëhet: “Për qëllime të llogaritjes së normës së kompensimit në masën 6%, ...”.

3.3 Shembulli i dhënë në pikën “2”, zëvendësohet me shembullin si më poshtë:

**Shembull**

Një fermer, i identifikuar si individ “A.B.”, i cili ushtron veprimtari si prodhues bujqësor në vreshtari dhe kultivon e prodhon rrush, ja shet këtë produkt shoqërisë “X”, e cila prodhon verë dhe është e regjistruar si person i tatueshëm për TVSHnë.

Fermeri “A.B.” i shet shoqërisë “X” rrushin për një vlerë 30.000 lekë ku përfshihen të gjitha kostot e prodhimit, puna e gjallë dhe fitimi i fermerit.

Shoqëria X i detyrohet fermerit A.B. për vlerën e furnizimit 30.000 lekë, plus normën e kompensimit 6 % ose 1.800 lekë. Pra, shuma gjithsej që shoqëria “X” do i paguajë fermerit “A.B.”, është  $30.000 + 1.800 = 31.800$  lekë.

Detyrimet e fermerit

Fermeri A.B. për të përfituar nga skema e kompensimit duhet të regjistrohet në drejtorinë rajonale tatimore për t'u pajisur me NIPT brenda dy ditësh pune. Drejtoria rajonale tatimore pajis me certifikatë NIPT-i fermerin, duke shënuar si emër "Fermeri A.B." dhe NIPT-in që gjeneron sistemi.

Detyrimet e personit të tatueshëm

Shoqëria "X", përpunues rrushi që merr furnizimin, përpara se të lëshojë faturën e parë në emër të fermerit, duhet të njoftojë drejtorinë rajonale tatimore përkatëse që është aplikues i skemës së kompensimit të fermerit duke i bashkëngjitur dhe marrëveshjen me fermerin.

Personi i tatueshëm "X", në momentin që ka marrë furnizimin prej fermerit, përpilon faturën tatimore të shitjes me TVSH. Në të dhënat identifikuese personi përgjegjës i blerësit (shoqërisë "X") që plotëson faturën, në të dhënat e shitësit shënon emrin e fermerit sipas regjistrimit përkatës

"Fermeri A.B."; NIPT: L.....N dhe të gjitha të dhënat e kërkuara sipas formatit të faturës.

Lidhur me furnizimin, në rubrikën përkatëse të faturës shënohen përkatësisht të dhënat e kërkuara mbi përshkrimin e mallit, njësinë, sasinë, çmimin për njësi etj.

Sipas shembullit të marrë ku vlera gjithsej e furnizimit është 31.800 lekë, pra kjo është shuma që blerësi person i tatueshëm do t'i paguajë shitësit fermer, në faturë, në vlerën e tatueshme do të shënohet vlera 30.000 lekë që përfaqëson vlerën e shitjes nga fermeri, ndërsa në kutinë e TVSH-së do të llogaritet nga shoqëria "X" norma e kompensimit 6 % e kësaj vlere të tatueshme, pra  $30.000 \text{ lekë} \times 6\% = 1.800 \text{ lekë}$ , dhe vlera totale e furnizimit do jetë 31.800 lekë.

Pra pavarësisht se vlera e furnizimit nga fermeri është 30.000 lekë (kostot dhe fitimi i tij), ai paguhet nga shoqëria "X" edhe me +6% mbi këtë vlerë, e cila përfaqëson normën e kompensimit për fermerin, shumë të cilën shoqëria "X" e merr përsëri nga TVSH-ja që llogaritet për shitjen e verës si person i tatueshëm që është, nëpërmjet mekanizmit të kreditimit të TVSH-së.

Në faturë duhet të shkruhet dukshëm "Vetëfaturim i TVSH-së sipas regjimit për kompensim të fermerit". Nëse fatura nuk ka këtë shënim, personit të tatueshëm X nuk i lejohet të zbresë TVSH-në e faturës. Fatura origjinale do të mbahet nga blerësi i produkteve dhe fermerit i jepet kopja e dytë e faturës. Kjo faturë nga personi i tatueshëm blerës regjistrohet në librin e blerjes në rubrikat përkatëse "Blerje nga fermerë", ilustruar si në librin bashkëngjitur.

MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
**Anila Denaj**